

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Së pari më lejoni të ju falënderoj për praninë tuaj në këtë konferencë të fundvitit dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe efektiv, që kemi kultivuar ndër vite me qëllim të informimit të drejtë të publikut rreth zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend.

Komunikimi me mediat gjithmonë paraqet një pjesë shumë të rëndësishme të aktivitetit të BQK-së, por në këtë vit shumë sfidues për të gjithë ne, komunikimi me mediat ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme. Përmes raportimit të drejtë nga ana juaj, ne kemi arritur që ta mbajmë publikun të mirë informuar si rreth zhvillimeve dhe masave lehtësuese në ekonominë e vendit, duke ndikuar që sjellja e publikut në raport me kushtet e krijuara në ekonomi të jetë racionale. Prandaj, dëshiroj që të shfrytëztoj këtë rast për të ju shprehur vlerësimin tim të lartë për sakrificën dhe profesionalizmin e treguar gjatë këtij viti të vështirë.

\*\*\*

Me gjithë vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar, unë jam i lumtur që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur edhe në këtë vit të zbatojë objektivat e saj, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, i cili jo vetëm se arriti të përballojë zhvillimet e pafavorshme ekonomike në vend, por edhe u shndërrua në njërën ndër shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët që hasën në vështirësi financiare për shkak të krizës pandemike.

\*\*\*

Tani, më lejoni që para jush të paraqes një përmbledhje të zhvillimeve që karakterizuan ekonominë dhe sistemin financiar të vendit gjatë këtij viti, duke u bazuar në të dhënat e fundit që i kemi në dispozicion për sektorët përkatës.

\*\*\*

Ashtu si në gjithë botën edhe në Kosovë, masat e ndërmarra për pengimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 e ndikuan në mënyrë mjaft të ashpër aktivitetin ekonomik, duke bërë që vendi të ballafaqohet me rënie ekonomike pas një periudhe mjaft të gjatë të rritjes ekonomike. Sipas parashikimeve të BQK-së, ekonomia e Kosovës në vitin 2020 pritet të shënojë një rënie prej 7.2 përqind në terma real, e cila paraqet goditjen më të rëndë që ka pësuar ekonomia në këto 20 vite. Kufizimi i funksionimit të shumë veprimtarive ekonomike ka ndikuar negativisht në të ardhurat e disponueshme të qytetarëve, duke ndikuar kështu negativisht në nivelin e konsumit të brendshëm. Po ashtu, dobësimi i performancës financiare të bizneseve, së bashku me pasigurinë për periudhën e ardhshme, kanë shkaktuar një rënie të konsiderueshme të investimeve.

Ndikim të rëndësishëm në rënien e aktivitetit ekonomik në Kosovë kishin edhe masat e kufizimit të lëvizjes nga shtetet tjera, të cilat reduktuan në masë të madhe vizitat e diasporës tonë në Kosovë, vizita këto të cilat paraqesin një burim mjaft të rëndësishëm të financimit për ekonominë e vendit. Bazuar në të dhënat e regjistruara deri në shtator 2020, shpenzimet e jorezidentëve në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave janë nga diaspora, ishin 470 milionë euro, e cila paraqet një rënie prej rreth 60 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në anën tjetër, kur jemi të lidhja e diasporës me ekonominë tonë, një faktor që ka ndikuar në zbutjen e efekteve të krizës kanë qenë pikërisht remitencat nga diaspora, të cilat edhe në këto kohë shumë të vështira për ekonominë botërore, vazhduan rrjedhën e qëndrueshme drejt ekonomisë tonë. Vlera e remitencave të pranuar deri në tetor 2020 ishte 796.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.9 përqind.

Zhvillimet që kanë ndodhur në ekonominë globale si pasojë e pandemisë kanë ndikuar edhe në tregtinë e jashtme. Zvogëlimi i kërkesës së brendshme në Kosovë gjatë këtij viti u reflektua në një vlerë më të vogël të importit të mallrave, i cili deri në tetor 2020 shënoi vlerën 2.63 miliardë euro apo një rënie vjetore prej 8

përqind. Në anën tjetër, eksporti i mallrave shënoi vlerën prej 382.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 19.1 përqind, mbështetur kryesisht në rritjen e eksportit të metaleve bazë. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, **deficiti tregtar** në llogarinë e mallrave gjatë kësaj periudhe regjistroi vlerën prej 2.26 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 11.4 përqind.

Në anën tjetër, eksporti i shërbimeve shënoi vlerën prej 731 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 48 përqind, që ka ndodhur kryesisht si rezultat i rënies së vizitave të bashkatdhetarëve tanë dhe turistëve në vend. Me rënie e karakterizua edhe importi i shërbimeve që regjistroi vlerën prej 434 milionë, duke shënuar një rënie vjetore prej 24.7 përqind.

Duke përfshirë edhe mallrat edhe shërbimet, del se vlera e përgjithshme e eksportit deri në shtator 2020 ishte rreth 1 miliard euro, përderisa gjithsej importet ishin rreth 2.6 miliardë euro. Deficiti tregtar duke përfshirë edhe llogarinë e mallrave edhe të shërbimeve regjistroi vlerën prej 1.6 miliard euro, apo rreth 22 përqind e Produktit të Brendshëm Bruto, nga rreth 18 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Për sa i përket investimeve të huaja direkte, vlera e tyre deri në shtator 2020 arriti në 250.6 milionë euro, në krahasim me vlerën prej 216.4 milionë euro të regjistruar deri në shtator 2019. Gjatë kësaj periudhe, rritje shënuan kryesisht IHD-të në sektorin e shërbimeve financiare, të cilat shënuan vlerën prej 66.2 milionë euro, në krahasim me vlerën prej 10.9 milionë euro të regjistruar deri në shtator 2019. Në anën tjetër, investimet në patundshmëri, të cilat paraqesin kategorinë kryesore të IHD-ve në Kosovë, zbritën në 135.8 milionë euro, nga 176.2 milionë euro sa ishin një vit më parë.

Për sa i përket treguesve tjerë makroekonomikë, vlen të theksohet se norma mesatare e inflacionit vjetor deri në muajin nëntor 2020 ishte 0.2 përqind në krahasim me normën prej 2.7 përqind të regjistruar në vitin 2019. Ky trend i

lëvizjes së çmimeve reflekton dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe rënien e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë gjatë këtij viti.

\*\*\*

Tani, më lejoni të kalojmë te zhvillimet në sistemin financiar të vendit:

Konform kushteve të reja të cilat u krijuan në ekonominë e vendit, BQK-ja u tregua proaktive duke reaguar shpejtë me qëllim që të ruhet funksionimi normal dhe qëndrueshmëria e sistemit financiar dhe në të njëjtën kohë, të vihet sistemi financiar në shërbim të ekonomisë.

\*\*\*

Në këtë mënyrë, që në ditët e para të masave kufizuese BQK-ja aktivizoi Ekipin e Vazhdimësisë së Punës, i cili kishte për detyrë të monitorojë dhe të japë udhëzime që sigurojnë mbarëvajtjen e funksioneve të BQK-së dhe të sistemit financiar në përgjithësi. Në këtë mënyrë, gjatë gjithë kohës i sigurova funksionimi i rregullt i sistemit të pagesave dhe furnizimit me para të gatshme në mbarë vendin, përfshirë këtu edhe zonat të cilat kanë qenë të izoluar për një periudhë më të gjatë kohore.

Banka Qendrore, që nga viti 2016 ka zhvilluar dhe operon me një sistem ndërbankar të pagesave të sigurt dhe të qëndrueshëm, i cili është i bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjatë këtij viti numri i llogarive bankare ka arritur në 2.26 milionë llogari, apo një rritje të numrit të llogarive bankare prej 4.3 përqind, që mund të arsyetohet me nevojën e bizneseve dhe individëve për hapjen e llogarive bankare për të përfituar nga masat lehtësuese ekonomike të Qeverisë. Po ashtu, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është regjistruar një rritje prej 22.4 përqind e llogarive që kanë qasje në e-banking, ku numri i llogarive e-banking deri në tetor 2020 është 393 mijë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020, BQK-ja ka përmbushur sigurimin e një furnizimi kualitativ dhe kuantitativ të kartëmonedhave dhe monedhave euro për sektorin bankar me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme të ekonomisë dhe qytetarëve.

Me qëllim të ballafaqimit në mënyrë sa më efektive me kushtet e krijuara, BQK-ja në vazhdimësi është koordinuar me të gjitha institucionet e Kosovës, institucionet financiare në Kosovë, odat ekonomike, si dhe institucionet financiare ndërkombëtare, duke mbajtur takime shumë të shpeshta për të siguruar ndërmarrjen e masave adekuate dhe në kohën e duhur kundrejt nevojave të ekonomisë.

BQK-ja që nga fillimi ishte pjesë e grupit ndërinstytucional për dizajnimin e masave emergjente për t'i dalë në ndihmë ekonomisë dhe më pas edhe për të hartuar planin e rimëkëmbjes ekonomike, i cili pak ditë më parë edhe u aprovua nga Kuvendi i Kosovës përmes kalimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike.

Si rezultat i komunikimeve tona të vazhdueshme, është aprovuar RFI (Rapid Financing Instrument) nga FMN-ja në shumë prej 52 milionë euro për të mbuluar nevojat urgjente dhe të përkohshme të bilancit të pagesave si rezultat i pandemisë COVID -19.

Po ashtu, pas koordinimit me bankat qendrore të regjionit, Banka Qendrore Evropiane ka aprovuar kërkesën e BQK-së për të vendosur një linjë financimi repo në shumë prej 100 milion euro. Kjo linjë e financimit i mundëson BQK-së të huazojë likuiditet në valutën euro nga Eurosistemi, për të adresuar nevojat e mundshme të likuiditetit për institucionet financiare në Kosovë në rast të mosfunksionimit të tregjeve për shkak të pandemisë COVID -19.

Duke parë se ekonomia e vendit po hynte në një krizë të theksuar, ku bizneset dhe qytetarët po ballafaqoheshin me vështirësi të mëdha financiare, BQK-ja duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në bashkëveprim me

institucionet kredidhënëse në Kosovë, ndërmori një varg masash për të ndihmuar ekonominë që të përballojë në mënyrë sa më të lehtë sfidat e kësaj krize.

Këto masa fillimisht konsistuan në aplikimin e moratoriumit për pagesat e kredive pa asnjë masë ndëshkuese për të gjithë huamarrësit që janë ndikuar negativisht nga pandemia. Ky moratorium përkohësisht i ka liruar kredimarrësit nga ngarkesa e pagesës së kredisë, duke e përmirësuar kështu pozitën e tyre të likuiditetit për financimin e nevojave të tjera.

Pas përfundimit të periudhës së moratoriumit, BQK-ja ka publikuar udhëzuesin për ristrukturimin e kredive me qëllim të vendosjes së kritereve në të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredive për huamarrësit që kanë hasur në vështirësi financiare si pasojë e pandemisë. Udhëzuesi për ristrukturimin e kredive ka bërë të mundur që t'u lehtësohet barra kreditore kredimarrësve pa implikuar ndonjë përkeqësim të klasifikimit të tyre në regjistrin kreditor të Kosovës.

Masat e ndërmarra nga BQK-ja u vlerësuan si shumë adekuate, si nga publiku vendor, ashtu edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar në raportin e Artikullit IV për Kosovën dhe Banka Botërore.

Po ashtu, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka mirëpritur përfundimet e nxjerra në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019, i cili njihet angazhimin dhe reformat e ndërmarra në sektorin financiar. Një hapësirë të veçantë raporti i KE-së i ka kushtuar zhvillimeve të lidhura me ndikimin e pandemisë në ekonominë e Kosovës, me ç'rast thekson masat e ndërmarra nga ana e BQK-së për të ndihmuar huamarrësit në tejkalimin e vështirësive financiare që kanë buruar si pasojë e krizës.

Në kuadër të vlerësimeve ndërkombëtare, vlen të theksohet edhe raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e investimeve për vitin 2020 për

Kosovën, ku është dhënë vlerësim i lartë për sistemin financiar të vendit. Në këtë raport është theksuar edhe qëndrueshmëria e sektorit bankar, i cili mbetet mirë i kapitalizuar dhe fitimprurës si dhe përmirësimi i dukshëm në vitet e fundit.

Kriza ekonomike e gjeti sektorin bankar të Kosovës në një gjendje shumë të shëndoshë, të karakterizuar me shkallë të lartë të likuiditetit, nivel të lartë të kapitalizimit dhe me cilësi shumë të mirë të portofolit kreditor me një pjesëmarrje prej vetëm pak mbi 2 përqind të kredive joperformuese. Kjo bëri që sektori bankar jo vetëm që arriti të përballojë rreziqet e rritura, por edhe të marrë një rol kyç në procesin e rimëkëmbjes ekonomike.

Kontributi i sektorit bankar në mbështetje të ekonomisë ishte shumë i rëndësishëm edhe në aspektin e vazhimit të kreditimit, përkundër ngritjes së nivelit të rreziqeve me të cilat u ballafaquan bankat. Gjatë periudhës janar - tetor 2020, vlera e kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar ishte 1.2 miliard euro, përderisa vlera e përgjithshme e kredive aktive në sektorin bankar në tetor 2020 ishte 3.2 miliard euro e cila paraqet një rritje vjetore prej 7 përqind.

Aktualisht, edhe pas ndërmarrjes së gjithë këtyre masave jo shumë të zakonshme për një sektor bankar dhe me një ekonomi e cila gjendet në një fazë recesioni, sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë dhe është i gatshëm të ushtrojë rolin e tij kyç në procesin e rimëkëmbjes ekonomike. Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike e sapo aprovuar nga Kuvendi i Kosovës parasheh një rol shumë të rëndësishëm për sektorin bankar. Një pjesë shumë e rëndësishme e kësaj pakoje bazohet në skemat e garantimit të kredive dhe subvencionimit të normave të interesit, të cilat do ta lehtësojnë dhe përmirësojnë rrjedhën e financimit bankar drejtë ekonomisë së vendit.

Gjithsej mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë këtij viti, duke arritur vlerën prej 5.05 miliardë euro në tetor 2020, e cila paraqet një rritje vjetore prej 10.3 përqind.

Sektorin bankar vazhdon të gëzojë besim të lartë tek publiku, besim ky i shprehur edhe me rritjen e vazhdueshme të depozitave. Në muajin tetor 2020, vlera e përgjithshme e depozitave ishte rreth 4.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.7 përqind. Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, kategori që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar me pjesëmarrje prej 67 përqind në totalin e depozitave, e të cilat në vitin 2020 shënuan rritje prej 7.3 përqind.

Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, duke zbritur në 6.3 përqind nga 6.5 përqind sa ishin në periudhën e njëjtë të periudhës së kaluar, gjë që tregon për lehtësim të vazhdueshëm të qasjes në financim bankar. Treguesit e shëndetit financiar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia e mirë e portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej vetëm 2.7 përqind në tetor 2020, e cila shënoi një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 2.2 përqind. Mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë mbetet në nivele të larta prej 140 përqind, që dëshmon për nivele adekuate të provizioneve në sektorin bankar.

Sektorin bankar vazhdon të ketë tregues të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.9 përqind në tetor 2020, krahasuar me 16.5 përqind në vitin paraprak, i cili vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal rregullativ prej 12.0 përqind.

Me qëllim të mbajtjes së niveleve të shëndosha të kapitalit brenda sistemit bankar dhe për të mbështetur ekonominë e Kosovës nëpërmjet kreditimit, BQK-ja ka marrë vendim për të pezulluar shpërndarjen e dividendës nga ana e bankave për vitin 2019 dhe 2020.

Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivel të lartë. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në tetor 2020 ishte 36.1 përqind, që ishte lartë mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.



Përveç sektorit bankar, rol të rëndësishëm në financimin kreditor të ekonomisë së Kosovës kanë edhe institucionet mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare, të cilat kryesisht fokusohen në ofrimin e mikrokredive. Vlera e përgjithshme e kredive të këtij sektori në tetor 2020 ishte 220 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 1.4 përqind.

Në sektorin e sigurimeve, deri në shtator 2020, u regjistrua një rënie e lehtë e aktivitetit. Primet e shkruara bruto deri në muajin shtator 2020 ishin 72.3 milionë euro, që paraqet një rënie prej 2.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej 35 milionë euro, me një rritje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur ishin 34.5 milionë euro.

Gjithsej mjetet e sektorit të sigurimeve kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë këtij viti, duke arritur shumën prej 214.3 milionë euro në shtator 2020, me një rritje vjetore prej 9.3 përqind.

Si rezultat i gjendjes së rënduar financiare dhe mos përmbushjes së kërkesave ligjore për kapital, si dhe në funksion të përmirësimit të gjendjes financiare, me qëllim të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe sigurimit të stabilitetit financiar të sektorit, BQK-ja gjatë këtij viti ka marrë vendimin për vendosjen nën administrim të përkohshëm të siguruesit "Kosova e Re". Ky vendim është në vazhdën e një sërë masave të ndërmarra nga ana e BQK-së për rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve, me qëllim të sigurimit të një sektori stabil dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të BQK-së.

Për sa i përket sektorit pensional, përkundër rënies së vlerës së investimeve në fillim të pandemisë, performanca e tregjeve financiare ndërkombëtare është përmirësuar vazhdimisht muajve të fundit dhe tashmë është rikuperuar vlera e rënies së vlerës së këtyre investimeve. Kthimi në investimet e Fondit të

Kursimeve Pensionale të Kosovës deri në fund të muajit shtator 2020 ishte pozitiv me një normë prej 12.5 përqind. Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike parasheh injektimin e një shume të konsiderueshme të parave në ekonomi (rreth 220 milionë euro) duke i mundësuar kontribuuesve pensionalë të tërheqin 10 përqind të kursimeve të tyre pensionale. BQK-ja ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në realizimin operacional të këtij procesi duke iu mundësuar fondeve të dhënat e llogarive bankare të kontribuuesve pensionalë nëpërmjet Regjistrimit të Llogarive Bankare me qëllim të kryerjes së validimit të llogarive të kontribuuesve dhe eliminimit të gabimeve të mundshme në kryerjen e pagesës së 10 përqindëshit.

\*\*\*

Përkundër situatës së krijuar për shkak të pandemisë dhe kushteve jo shumë të favorshme në tregjet ndërkombëtare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur të ruajë qëndrueshmërinë e saj financiare dhe performancën e mirë të institucionit.

BQK-ja mbetet e përkushtuar që të vazhdojë aktivitetin e saj në shërbim të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit, duke krijuar kushtet për zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme financiare, në linjë me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë, duke përfshirë edhe zhvillimin e segmenteve të reja të sistemit financiar siç është tregu i kapitalit, i cili kërkon një bashkëveprim të gjerë ndërinstitucional.

Po ashtu, BQK mbetet e përkushtuar që zhvillimin e sistemit financiar ta bazojë mbi parimet e zhvillimit të konkurrencës së shëndoshë dhe lëvizjes së lirë të kapitalit, duke promovuar kështu rritjen e vazhdueshme të efikasitetit në sistemin financiar.

\*\*\*

Më lejoni të shpreh falënderimin tim për Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, për ndarjen e çmimit “Praktika më e mirë në zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve” për vitin 2020 për BQK-në.

Po ashtu, dëshiroj të ju njoftoj se BQK-ja edhe në këtë vit ka vazhduar me shpalljen e konkursit, tanimë tradicional, për çmimin “Ekonomist i Ri”, me

ç ‘rast dëshiroj t’i falënderoj dhe përgëzojë të gjithë kandidatët për punimet e tyre që i kanë dorëzuar në kuadër të kësaj gare. Ky aktivitet ka për qëllim nxitjen e aktivitetit hulumtues në fushën e ekonomisë në mesin e të rinjve.

Bazuar në vlerësimin e komisionit profesional për vlerësimin e këtyre punimeve, unë sot kam kënaqësinë që të shpallë fituesin e këtij çmimi, Qendrim Shkodra me temën “Ekonomia e Kosovës në kohë Pandemie, ndikimet e COVID-19 në ekonominë vendore dhe ndërkombëtare”.

Në fund, duke shpresuar dhe besuar se viti i ardhshëm do të jetë një vit më pozitiv në të gjitha aspektet, ju uroj shumë shëndet, gëzime dhe suksese të gjithë juve dhe familjeve tuaja.